

Msc. Fatjon Balliu
Ma. Rezart Mezani

ARKIVI DHE DOMOSDOSHMERIA E ARKIVIMIT TË MEDIAVE SOCIALE

Përmbledhje

Arkivat janë dëshmitare të së kaluarës. Ato u ofrojnë studiuesve, historianëve dhe ekspertëve të fushave të ndryshme prova, shpjegime dhe arsyetime për veprimet e kaluara dhe komunikimin e brezave për vendimet aktuale. Këto institucione, me qasjen në dokumentacion që i mundësojnë shoqërisë, ndikojnë në zhvillimet ekonomiko-sociale, në kapërcimin e barrierave kulturore, fizike, politike dhe ky është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e një identiteti më gjithëpërfshirës për shoqërinë.

Vitet e fundit mediat sociale janë shndërruar në një nga kanalet më të pëlqyera të komunikimit qoftë në sferat private, ashtu edhe në ato publike. Administrata publike ka filluar përdorimin e mediave sociale duke rikrijuar marrëdhëniet me qytetarin me synimin thelbësor që është përmirësimi i shërbimit në kohë dhe cilësi. Natyrisht është i pamohueshëm fakti se përdorimi i mediave sociale do të jetë një burim me rëndësi parësore për brezat e ardhshëm.

Në këtë punim synojmë ta shprehim përhapjen e përdorimit të mediave sociale, rëndësinë e dokumenteve të krijuara në këto media dhe arkivimin e tyre.

Fjalë kyçe: *media sociale, arkivim, arkivim digjital, të dhëna personale, akses*

ARCHIVES AND THE NECESSITY OF ARCHIVING SOCIAL MEDIA

Abstract

Archives are witnesses of the past. They provide researchers, historians and experts of different fields with proofs, interpretations and reasons for the actions of the past; archives are the means of communication between generations. These institutions, while offering society access to the records, influence positively the economical and social developments, help into trespassing the cultural, physical and political barriers, what contributes into developing an extensive identity of our society.

On the last years, social medias have been transformed into the favorite channels of communication, be it in the private sphere, but also in the public level. Public administration has started to use social media, creating thus a relationship with citizens, aiming the improvement of the service in time and quality. Naturally, the usage of the social medias in the future will be an important source of communication for the future generations.

In this paper we will try to analyze the extension of the social medias, the importance of the documents created by them and the importance of their preservation.

Në vitet e fundit përdorimi i rrjeteve sociale si “Twitter”, “Facebook” etj. ka marrë një përhapje të gjerë duke u bërë pjesë e zhvillimeve të jetës sonë. Të dhënat e formuara në rrjetet sociale, formojnë burime të konsiderueshme për studiuesit, si historianë, sociologë, psikologë, studiues të shkencave politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare që synojnë të bëjnë punime mbi zhvillimet e shoqërisë në shek. 21.¹

Mediat sociale janë mjete të ndërmjetësuara nga kompjuteri që lejojnë krijimin, ndarjen ose shkëmbimin e informacionit, ideve, imazheve, tingujve, videove në komunitete dhe rrjete virtuale. Aplikacionet e bazuara në internet, të ndërtuara në bazat ideologjike dhe teknologjike të Web 2.0, lejojnë krijimin dhe shkëmbimin e përmbajtjes së gjeneruar nga përdoruesit².

Mediat sociale, me përdorimin e gjerë që kanë marrë, janë bërë kanale të pëlqyera për komunikim si në sferën private ashtu edhe në atë publike. Tashmë nuk janë më vetëm individët, por edhe kompanitë i përdorin rrjetet sociale për të njohur në tregun virtual produktet e veta dhe për të komunikuar me klientët e tyre. Një e-mail i dërguar nga klienti në adresën e kompanisë, tani është një postim në faqen që kjo kompani ka hapur në rrjetet sociale, si “Facebook”, “Twitter”, “Instagram” etj.³

Në fillimet e veta “Facebooku” ishte dizajnuar për sferën private, për argëtim dhe mundësi për t’i mbajtur lidhjet shoqërore. Tani situata është plotësisht ndryshe. Bizneset kanë nevojë për një adresë në “Facebook” e cila mundëson lidhje më të shpejta me konsumatorin dhe klientët e mundshëm.⁴

Arkivat janë produkte dokumentare të veprimtarisë njerëzore dhe ruhen për shkak të vlerës së tyre afatgjatë. Puna arkivore është një mënyrë për ta siguruar ruajtjen e të dhënave dhe dokumenteve të formuara nga fond-

¹ Lina Bountouri, Georgios Giannakopoulos, *The Use of Social Media in Archives, Procedia - Social and Behavioral Sciences* 147, (2014) f. 510-517; Stefano Allegrezza, *L’archiviazione dei social media e la loro conservazione a lungo termine: criticità e possibili soluzioni*, <http://www.documento-elettronico.it/it/workshop/workshop-2015/atti-della-giornata/139-l-archiviazione-dei-social-media-e-la-loro-conservazione-a-lungo-termini-criticita-e-possibili-soluzioni>; Giann Akopoulos, *In search of integrate dinformation, Education for Information* 26, 2008, pp. 113-119; Giann Akopoulos and J. Koumantakis, *Archival Studies in Greeceand the Emerging Field of Integrated Information, Libraryreview*, 2014,

² Andreas M. Kaplan, Michael Haenlein, *Usersof the world, unite! The challenges and opportunities of social media, Business Horizons* 53 (1), 2010, pp. 61

³ Cosenza V., *Le performance di Comuni e Regioni sui social media*, 28 maggio 2013, <http://www.blogmeter.it/blog/2013/05/28/le-performance-di-comuni-e-regioni-sui-social-media>

⁴ Madhava R., *10 gjërat që duhet të dini për ruajtjen e mediave sociale. Shih Menaxhimi i informacionit, shtator/tetor* 2011; http://content.arma.org/imm/Shtator-Tetor2011/10thith_stoknowabout_preservimisocialmedia.aspx

krijues si institucione, organizata, komunitete, individë. Dokumentet arkivore paraqiten në një shumëllojshmëri formatesh të shkruara, fotografike, audiovizive, në formë digjitale ose analoge.⁵ Sistemet arkivore na mundësojnë qasjen në këto të dhëna në bazë të Ligjit për Arkiva në vendet përkatëse. Institucionet, bizneset, organizatat, për ta ruajtur punën e kryer dhe për të mos pasur probleme në sistemet e veta, janë të detyruara të ngrehin një sistem arkivor. Ky sistem, përveç vijueshmërisë, mundëson edhe kontrollin e sistemit të ngritur në këto institucione. Për këto arsye është e domosdoshme të mbahen gjurmë të prodhimit të dokumenteve, nga është formuar, formati, përmbajtja dhe mënyra se si është formuar.⁶ Megjithatë, duhet të kihet parasysh që dokumenti arkivor është produkt i një individi ose një organizate dhe mbart përbrenda botëkuptimin, paragjykimin dhe këndvështrimin e tyre. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për personin që bën vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave që mbart dokumenti arkivor.⁷

Arkivat nuk janë domosdoshmërisht letra të vjetra. Mjafton që të kenë tejkaluar jetën e tyre të dobishme administrative për të fituar këtë status. Ato vijnë në media të ndryshme, analoge ose digjitale, dhe jo vetëm në letër. Arkivat përfshijnë dokumente të shkruara, por edhe burime elektronike (përfshirë faqet e internetit dhe postën elektronike), fotografi, filma dhe regjistrime zanore.⁸

Rritja e përdorimit të internetit në mënyrë paralele ka sjellë edhe rritjen e veprimtarive sonë në internet, ku shitblerjet zënë një vend të rëndësishëm. Sidomos jeta intensive në qytet ka ndikuar më shumë në përdorimin e rrjeteve sociale në veprimtaritë institucionale dhe individuale. Konsumatorët, të cilët bëjnë blerje nëpërmjet internetit, dashur pa dashur bëhen pjesë e marrëveshjeve në distancë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe të përgatitura nga institucionet përkatëse që ofrojnë shërbime online. Sot shumica e bizneseve dhe institucioneve marrëveshjen elektronike e ofrojnë nëpërmjet internetit. Nga ana tjetër është i pashmangshëm rregullimi i statusit ligjor për problemet që lindin nga zhvillimet e teknologjisë dhe përdorimi i rrjeteve sociale.⁹

Të dhënat elektronike që gjenden në uebsajtet e institucioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme nëpërmjet marrëveshjeve dhe kontra-

⁵ <https://www.ica.org/fr/node/14777>

⁶ <https://www.ceylancelik.com.tr/arsivleme-araclari-nelerdir/>. Veçoritë që duhet t'i kenë arkivat: origjinaliteti, besueshmëria, qasja, integriteti

⁷ <https://www.ica.org/fr/node/14777>

⁸ <https://www.ica.org/fr/node/14777>

⁹ Özge Uzun Kazmacı, *Internet Ortamında Kurulan Mesajlı Sözleşmelerde Tüketicinin Korunması*, <https://dergipark.org.tr/tr/download/article-file/373445>

tave në distancë, elektronike, mund të përdoren në bazë të një statusi ligjor të përcaktuar më parë, në mënyrë të ndërsjellë midis palëve.¹⁰

Përdorimi i internetit ka sjellë edhe koncepte të reja, siç është prova digjitale. Të gjitha veprimet që kryhen në internet formojnë të dhëna digjitale, të dhëna numerike dhe këto formojnë argumentin digjital. “Argument elektronik ose digjital është një e dhënë, regjistrim ose dokument digjital që formohet, ruhet, ndryshohet dhe transmetohet në një ambient elektronik i cili përdoret për të vërtetuar veprimin e pohuar”.¹¹ Një çështje e rëndësishme e argumentit digjital është besueshmëria. Këto argumente që krijojnë vështirësi në përcaktimin e përkatësisë, të afrojnë mundësi të lehtë për tjetërsim dhe prishje të të dhënave digjitale dhe kjo përbën pikën më të dobët të zinxhirit të argumentit digjital.¹² Duke parë zhvillimet në botën elektronike dhe problematikat që lindin, sot po merren masa për ta rregulluar statusin ligjor të të dhënave digjitale, ndjekjen dhe depozitimin e tyre.¹³

Sot arkivistët, për ta përmbushur misionin e tyre, duhet të bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë, siç janë specialistët e IT-së. Ata, gjithashtu, duhet të punojnë ngushtë me përdoruesit për të siguruar që fondet dhe shërbimet e ofruara t’i përmbushin pritshmëritë e tyre.¹⁴

Shumë studiues besojnë se mediat sociale mund të përdoren për ta promovuar imazhin publik dhe strategjinë e komunikimit të shërbimeve arkivore. Programimi publik mund të përmirësohet duke përdorur teknologjitë e mediave sociale, veçanërisht në vendet që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të shpenzuar në strategjinë e tyre të komunikimit.¹⁵

Sot kemi përdorimin e arkivave digjitale. Arkivi digjital është sistem kompjuterik që mundëson depozitimin, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave digjitale. Qëllimi kryesor i projekteve të arkivit digjital është ashtu si dokumentet e tjera t’i mbrojnë të dhënat që janë prodhuar në mjedis digjital, të mundësojë qasje në përdorimin e tyre dhe në këtë mënyrë të transmetojë në brezat e ardhshëm pasuri kulturore digjitale të mbledhur.

¹⁰ Turgay Sariakçali, *Internet Üzerinden Akdedilen Sözleşmelere Uygunlanacak Hukuk*, *Public and Private International Law Bulletin*, Istanbul Üniversitesi Yayınevi, 2020, nr. 40(1), fl. 247-297

¹¹ Çetin Arslan, *Dijital Delil ve İletişimin Denetlenmesi*, CHKD, Cilt: 3, Sayı: 2, 2015, fl. 255

¹² Po aty fl. 256

¹³ Veli Özer Özbek, *Ceza Muhakemesi Hukukunda Dijital Verilerin Delil Değeri, Ceza ve Ceza Usulü Hukuku Ad*, Dokuz Eylül Üniversitesi Hukuk Fakültesi, İzmir, Türkiye Klinikleri J. Foren Med-Special Topics. 2017; 3(3):166-70

¹⁴ <https://www.ica.org/fr/node/14777>

¹⁵ Fr. Garaba, *Availing the liberations struggle heritage to the public: some reflections on the use of Web 2.0 technologies in archives within the East and Southern Africa Regional Branch of the International Council on Archives (ESARBICA)*, *Information Development*, 2012, 28:1, 22-31

Arkivi i uebfaqeve është proces i mbledhjes të të dhënave në këto faqe të tyre. Arkivat ueb janë sisteme të mbledhjes së të dhënave, depozitimit të tyre dhe t'u ofrojnë studiuesve kushte për kërkime. Edhe këto uebfaqe që përdoren për arkivizimin e faqeve digjitale janë të njëjta me dokumentacionin klasik të letrës, pasi dhe te këto zgjidhen të dhënat, depozitohen, ruhen dhe u jepet qasje individëve për t'i përdorur ato.

Në këto arkiva ueb u jepet mundësi qeverive, botës së punës, institucioneve, kërkuesve, historianëve dhe publikut të gjerë të kenë qasje.¹⁶

Një shembull i krijimit të arkivit të mediave sociale është ai i Mbretërisë së Bashkuar. Ai është i pajisur me një funksion kërkimi, që lejon përdoruesit të kërkojnë me lehtësi në koleksionin e tweet-eve, imazheve të Flickr dhe videove në YouTube nga një sërë departamentesh të qeverisë qendrore dhe organeve të tyre. Përmes faqeve të hyrjes të sapo-dizajnuara, përdoruesit tani mund të kryejnë kërkime të fjalëve kyçe dhe t'i filtrojnë rezultatet nga departamenti qeveritar, periudha kohore dhe platforma.

John Sheridan, drejtor në Arkivat Kombëtare Britanike, është shprehur: *“Ne me të vërtetë po hapim terren të ri këtu, duke përmirësuar qasjen e publikut në një koleksion të rëndësishëm që regjistron përdorimin e qeverisë të mediave sociale. Është detyrë jona të mbajmë dhe ta vëmë në dispozicion regjistrin, çfarëdo forme që të marrë. Ky koleksion i mediave sociale kontribuon në kuptimin tonë të ngjarjeve të fundit dhe do të ruhet si pjesë e regjistrit zyrtar publik për brezat që do të vijnë. Është e rëndësishme që jo vetëm të zhvillohet një praktikë e re arkivore për llojet e të dhënave që mund të ruajmë, por t'i përmirësojmë mënyrat se si mund të arrihen të dhënat nga publiku. Me futjen e funksionit të kërkimit, gjetja e përmbajtjes përkatëse të mediave sociale në arkiv është më e thjeshtë se kurrë më parë”*¹⁷

Një nga problemet kryesore që sjell arkivizimi i të dhënave të rrjeteve sociale është ruajtja e konfidencialitetit dhe shtetet e mëdha kërkojnë që të kenë qasje në arkivat e këtyre rrjeteve sociale nëpërmjet lidhjeve me krijuesit e tyre ose me ata që i menaxhojnë. Një shembull konkret: Turqia kërkoi që “Facebook”-u të ketë një përfaqësues në këtë vend. Këtë kërkesë e bazoi në ligjin nr. 5651.¹⁸

¹⁶<https://www.bilgibilimi.net/dijital-arsiv/>; <https://www.gazeteduvak.com.tr/kultur-sanat/2017/11/14/ankara-komedi-festivali-demam-ediyor>

¹⁷ <https://www.nationalarchives.gov.uk/about/news/the-social-media-archive-is-now-fully-searchable/>

¹⁸ <https://www.trthaber.com/haber/gundem/facebook-turkiye-temsilci-atayacak-548309.html>

Referenca:

- Arslan, Çetin, *Dijital Delil ve İletişimin Denetlenmesi*, CHKD, Cilt: 3, Sayı: 2, 2015
- Bountouri, Lina; Giannakopoulos, Georgios, *The Use of Social Media in Archives*, *Procedia - Social and Behavioral Sciences* 147, (2014); Allegrezza, Stefano, *L'archiviazione dei social media e la loro conservazione a lungo termine: criticità e possibili soluzioni*, <http://www.documento-elettronico.it/it/workshop/workshop-2015/atti-della-giornata/139-l-archiviazione-dei-social-media-e-la-loro-conservazione-a-lungo-termine-criticita-e-possibili-soluzioni>; Akopoulos, Giann, *In search of integrate dinformation*, *Education for Information* 26, 2008; Akopoulos, Giann; Koumantakis, J., *Archival Studies in Greece and the Emerging Field of Integrated Information*, *Libraryreview*, 2014
- Garaba, Fr., *Availing the liberations struggle heritage to the public: some reflections on the use of Web 2.0 technologies in archives within the East and Southern Africa Regional Branch of the International Council on Archives (ESARBICA)*, *Information Development*, 2012
- M. Kaplan, Andreas; Haenlein, Michael, *Users of the world, unite! The challenges and opportunities of social media*, *Business Horizons* 53 (1), 2010
- Özer Özbek, Veli, *Ceza Muhakemesi Hukukunda Dijital Verilerin Delil Değeri, Ceza ve Ceza Usulü Hukuku Ad*, Dokuz Eylül Üniversitesi Hukuk Fakültesi, İzmir, Türkiye Klinikleri J. Foren Med-Special Topics, 2017
- R., Madhava, *10 gjërat që duhet të dini për ruajtjen e mediave sociale*. Shih *Menaxhimi i informacionit*, shtator/tetor 2011; http://content.arma.org/imm/Shtator-Tetor2011/10thith_stokknowabout_preservimisocialmedia.aspx
- Sariakçali, Turgay, *Internet Üzerinden Akdedilen Sözleşmelere Uygunlanacak Hukuk*, *Public and Private International Law Bulletin*, Istanbul Üniversitesi Yayınevi, 2020, nr. 40(1)
- Uzun Kazmacı, Özge, *İnternet Ortamında Kurulan Mesafeli Sözleşmelerde Tüketicinin Korunması*, <https://dergipark.org.tr/tr/download/article-file/373445>
- V., Cosenza, *Le performance di Comuni e Regioni sui social media*, 28 maggio 2013, <http://www.blogmeter.it/blog/2013/05/28/le-performance-di-comuni-e-regioni-sui-social-media>
- <https://www.ica.org/fr/node/14777>
- <https://www.ceylancelik.com.tr/arsivleme-araclari-nelerdir/>. Veçoritë që duhet t'i kenë arkivat: origjinaliteti, besueshmëria, qasja, integriteti
- <https://www.ica.org/fr/node/14777>
- <https://www.ica.org/fr/node/14777>
- <https://www.ica.org/fr/node/14777>
- <https://www.bilgibilimi.net/dijital-arsiv/>; <https://www.gazeteduvar.com.tr/kultur-sanat/2017/11/14/ankara-komedi-festivali-demam-ediyor>
- <https://www.nationalarchives.gov.uk/about/news/the-social-media-archive-is-now-fully-searchable/>
- <https://www.trthaber.com/haber/gundem/facebook-turkiye-temsilci-atayacak-548309.html>

